

Nr. prot. 143

Nr. prot. 7

### **Marrëveshje Bashkepunimi**

E lidhur në Tiranë, sot më 06 /02/2023, midis palëve:

**Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)**, organizatë jo-fitimprurëse, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me Vendimin e Gjykatës nr. 1153, datë 14/04/1999, me seli në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 9, Apartamenti 3, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm (më poshtë AAB).

Dhe

**Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)**, Rr. “Papa Gjon Pali i II”, Nr. 3, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Igli Tafa, Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor (më poshtë AKCESK)

Meqenëse ekzistojnë kushtet paraprake si vijon:

- Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), ne datën 7 shkurt 2023, organizon Konferencën “Sfidat e Sigurisë Kibernetike në Shqipëri”.
- Shoqata Shqiptare e Bankave ka për synim rritjen e sigurisë kibernetike në sektorin bankar dhe jo vetëm, si dhe ndarjen mes tyre të sfidave të sigurisë kibernetike.

Palët bien dakord për lidhjen e kësaj Marrëveshje si më poshtë vijon:

#### **Neni 1 Objekti i Marrëveshjes**

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është mbështetja financiare e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për zhvillimin e aktivitetit që do të zhvillohet e datë 7 shkurt 2023 me temë “Sfidat e Sigurisë Kibernetike në Shqipëri”.
- 1.2 Rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve lidhur me ofrimin, pranimin dhe përfitimin e këtij financimi.
- 1.3 Rregullimin e afateve, kushteve dhe mënyrës së kryerjes së shërbimeve, pagesës dhe përfitimit.



**Neni 2**  
**Baza ligjore**

Kjo Marrëveshje hartohet në përputhje me dispozitat e Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

**Neni 3**  
**Dakordësimi ndërmjet palëve**

- 3.1 Palët bien dakord që shuma që AAB do të vërë në dispozicion për AKCESK do të jetë në vlerën prej 10 000 (dhjetë mijë) euro përfshirë TVSH, ose kundravlerën e kasaj shume në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të ditës të lëshimit të faturës, përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
- 3.2 Palët bien dakord që AKCESK do të përdorë vlerën e mësipërme për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve për organizimet e aktivitetit të parashikuar në nenin 1, pika 1.1 të kësaj Marrëveshje.
- 3.3 Palët bien dakord se AKCESK, nëpërmjet subjekteve që do të ofrojnë shërbimet e tyre për organizimin e kësaj Konference, do të lëshojnë faturë në emër të AAB-së për vlerën e rënë dakord në pikën 3.1
- 3.4 Palët bien dakord se pagesa prej AAB-së do të kryhet në llogarinë subjekteve përkatëse sa parashikuar ne pikën 3.3 më lart sipas faturës tatimore përkatëse.

**Neni 4**  
**Detyrimet e palëve**

*4.1. AAB merr përsipër:*

- a. Të realizojë pagesën e parashikuar në nenin 3 pika 3.1 të Marrëveshjes për nevojat e identifikuar nga AKCESK, që lidhen me organizimin e aktivitetit.
- b. Pagesa të kryhet jo më vonë se pesë ditë pune nga momenti i mbërritjes së faturës tatimore.
- c. Të deklarojë se pagesa është në përputhje të plotë me kërkesat e rëna dakord midis palëve.

*4.2. AKCESK merr përsipër:*

- a. Të dorëzojë faturën/at që vërtetojnë përdorimin e fondeve të vëna në dispozicion nga AAB sipas qëllimit të përcaktuar në nenin 1.1 të kësaj Marrëveshje.
- b. Të përdorë fondet e vëna në dispozicion nga AAB në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshje.
- c. Të vendosë logon e AAB-së, si bashkëpunetore në materialet e marketimit të aktivitetit dhe përgjithë zhillimit të tij nëse do të jetë e mundur.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe përfundimi i saj**



- 5.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe është e vlefshme deri në përfundimin e aktivitetit dhe kryerjes së pagesave sipas parashikimit.
- 5.2 Palët, me vullnetin e tyre, mund të zgjidhin Marrëveshjen me efekt të menjëhershëm nëse nuk janë plotësuar kushtet e Marrëveshjes të parashikuara në nenin 4.

## **Neni 6**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet AAB dhe AKCESK, do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt palët i drejtohen për zgjidhjen e tyre Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

## **Neni 7**

### **Njoftimet**

Të gjitha njoftimet, korrespondenca, paralajmërimet, deklaratat e dhëna ose që kërkohen sipas kësaj Marrëveshje do të jenë me shkrim dhe do të regjistrohen në protokollin institucional të palëve të përfshira në këtë Marrëveshje. Të gjitha njoftimet do të jenë të vlefshme në momentin që do të merren nga Pala ose kur Pala tjetër e regjistron atë në protokollin institucional, cilado të jetë e mëparshme, dhe do të dorëzohen dorazi, me postë të regjistruar sipas adresave të Palëve të përmendura më poshtë. Në rast të ndryshimit të ndonjë adrese, Pala që ka ndryshuar atë është e detyruar të informojë Palën tjetër me shkrim.

**a) Për AKCESK :**

Edlira Gjolleshi

Adresa: "Papa Gjon Pali i II", Nr. 3, Tiranë

E-mail: [Edlira.Gjolleshi@cesk.gov.al](mailto:Edlira.Gjolleshi@cesk.gov.al)

Tel: +355682086868

**b) Për AAB:**

Brunilda Kostare

Adresa: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, A 9/3

E-mail: [brunilda.kostare@aab-al.org](mailto:brunilda.kostare@aab-al.org)

Tel: +355 4 2280371/2

## **Neni 8**

### **Dispozita të fundit**

- 8.1 Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj marrëveshje.
- 8.2. Çdo ndryshim apo shtesë e kësaj Marrëveshje do të bëhet vetëm në formë të shkruar.



8.3 Kjo marrëveshje u hartua në 2 (dy) kopje, nga nje kopje origjinale për secilën palë, në gjuhën shqipe, të cilat pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.

Kushtet e mësipërme miratohen dhe kjo Marrëveshje nënshkruhet në emër të palëve:

**Shoqata Shqiptare e Bankave**

*Spiro Brumbulli*  
**Spiro Brumbulli**  
Sekretar i Përgjithshëm



**Autoriteti Kombëtar për Certifikimin  
Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike**

*Igli Tafa*  
**Igli Tafa**  
Drejtor i Përgjithshëm

